



Prishtinë: 22.12.2010

Kodi i ZRRE-së: V\_325\_2010

Nr. i Referencës: ZRRE/DMK\_V\_476\_10\_10

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Kompetencat e Zyrës së Rregullatorit për Energji të dhëna në nenin 16 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë;
2. Dispozitat sipas Kapitullit 3, Nenit 17 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
3. Dëshmitë e paraqitura nga palët;
4. Vendimin e DMK të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_476\_10\_10**;
5. Apelimi i konsumatorit me datë 08.12.2010;
6. Nenin 18 të Rregullës mbi Procedurën e Zgjidhjes së Kontesteve në Sektorin e Energjisë;

**Në mbledhjen e mbajtur më 22 dhjetor 2010 nxori këtë:**

### VENDIM

**APROVOHET pjesërisht** apelimi i konsumatorit Zeqir Dragusha nga fshati Prugovc si në arsyet e paraqitura në arsyetimin e këtij vendimi.

### Arsyetim

Konsumatori në ankesën e tij drejtuar DMK-së në ZRRE me datë 23.03.2010 ka apeluar përgjigjen e KEK Sh.A – Divizioni i Furnizimit – Departamenti për Konsumatorë të datës 16.02.2010 lidhur me kontestimin e ngarkesës së shfrytëzimit të paautorizuar.

- Me datë 04.03.2008 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë bërë inspektimin e pikës matëse të konsumatorit dhe kanë konstatuar se konsumatori nuk e posedon njehsorin elektrik dhe se furnizohet direkt nga rrjeti me kabull 4x10 mm<sup>2</sup> si dhe bazuar në urdhëresën për shkyçje për shkak të borxhit, konsumatori shkyçet.  
**Provë:** Procesverbali i KEK-ut nr. 0129273, datë 04.03.2008
- Me datë 15.10.2008 konsumatori ka bërë kërkesë zyrtare pranë KEK-ut për lidhje të re.  
**Provë:** Dëftesa e KEK-ut datë 15.10.2008
- Me datë 02.04.2009 konsumatori ka përsëritur kërkesën për lidhje të re.  
**Provë:** Dëftesa e KEK-ut datë 15.10.2008

- Me datë 15.04.2009 me kërkesë të konsumatorit për lidhje të re punëtorët e autorizuar te KEK-ut për ndërrim njehsori kanë dalë te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik, ku kanë hequr nga matja njehsorin elektrik nr. 6840930 dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 41547595 dhe vulosur me vulë distributive A1 0054995.  
**Provë:** Vërtetim mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nr. 000330 datë 15.04.2009
- Me datë 08.10.2009 punëtorët e qendrës së kalibrimit kanë bërë kontrollimin detal të njehsorit elektrik nr. 6840930, ku është konstatuar se njehsori elektrik vulat (bllobat) shtetërore i ka në rregull, nga ana e jashtme dëmtime nuk ka si dhe në brendi të njehsorit komisioni nuk ka mundur të vërej ndonjë parregullsi.  
**Provë:** Procesverbali me nr. 08/8 i datës 08.10.2009
- Me datë 10.03.2008 KEK-u e ka ngarkuar konsumatorin me ngarkesë për shfrytëzim të paautorizuar me anë të faturës DPR08HP04927 në vlerë prej 4,123.65 €.  
**Provë:** Fatura DPR08HP04927 e datës 10.03.2008
- Konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për Konsumatorë në KEK duke kundërshtuar ngarkesën për shfrytëzim të paautorizuar të energjisë elektrike.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në KEK
- Me datë 16.02.2010 Departamenti për Konsumatorë në KEK i është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar dhe duke thirrur në procesverbalin e kontrollës.  
**Provë:** Përgjigja e KEK-ut e datës 16.02.2010
- Me datë 23.03.2010 konsumatori ka apeluar përgjigjen e KEK-ut në DMK të ZRRE-së.  
**Provë:** Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRRE-së
- Me datë 18.10.2010 DMK në ZRRE ka lëshuar vendimin **ZRRE/DMK\_V\_476\_10\_10** me të cilin ka refuzuar ankesën e konsumatorit.  
**Provë:** Vendimi ZRRE/DMK\_V\_476\_10\_10 i datës 18.10.2010
- Me datë 08.12.2010 konsumatori ka apeluar vendimin e DMK-së **ZRRE/DMK\_V\_476\_10\_10** të datës 18.10.2010.  
**Provë:** Ankesa (apelimi) i konsumatorit

Bordi i ZRRE-së ka analizuar Vendimin e lëshuar nga DMK: **ZRRE/DMK\_V\_476\_10\_10** dhe ka vendosur që të **aprovojë pjesërisht** apelimin e konsumatorit për arsye të neglizhencës së KEK-ut pasi që KEK-u në momentin e parë të evidentimit nga lexuesi se mungon njehsori elektrik është dashur që të marrë masa, vendos njehsorin elektrik me qëllim që të pamundësojë keqpërdorimin e energjisë elektrike nga konsumatori

Sipas këtij vendimi, KEK-u është i obliguar që:

1. Të shkarkoj konsumatorin nga fatura për rikthim të humbjeve DPR08HP04927 në vlerë prej 4,123.65 € të datës 10.03.2008;
2. Të ngarkojë konsumatorin me faturën për rikthim të humbjeve (për 12 muaj) duke u bazuar në mesataren mujore të energjisë elektrike të shpenzuar me njehsor të ri elektrik nr. 41547595 për periudhën 06/2009 deri 05/2010.

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij Vendimi, pala ka të drejtë të iniciojë procedurë gjyqësore në Gjykatën Kompetente, brenda **katërmëdhjetë (14) ditësh** prej ditës së pranimit të këtij Vendimi.

**Bordi i ZRRE-së**

---

Dr. Ali Hamiti, kryesues

---

Theranda Beqiri, anëtare

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar